

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
INSTITUCIONI NACIONAL QENDRA PËR KONSERVIM – GOSTIVAR

Bazuar në nenin 76-b paragrafi 1, alinea 6, neni 77-b, neni 77-v, neni 77-g dhe neni 77-d nga Ligji për kulturë (GZ e RM nr. 31/98, 49/03, 82/05, 24/07, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13, 187/13, 44/14, 61/15, 154/15, 39/16, 11/18 i 11/18), neni 20-g nga Ligji për të punësuarit në sektorin publik (GZ e RM nr. 27/14, 199/14, 27/16, 35/18, 198/18 dhe GZ e RMV nr.143/19), neni 22 dhe neni 23 nga Ligji për marrëdhënie pune (GZ e RM nr. 62/05...151/2021), vendimi për shpallje publike me numër arhiv nr.0401-108/1 nga 06.07.2022, Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e shpalljes publike nr.0101-107/4 nga 05.07.2022 në IN Qendra për Konservim – Gostivar dhe Pëlqimi nga Ministria e financave RMV me nr.18-1779/2 nga 10.05.2022, IN Qendra për Konservim – Gostivar shpall:

SHPALLJE PUBLIKE nr.01/2022
për punësim të 3 (tre) ofrues të shërbimeve me kohë të përcaktuar
në periudhë kohore deri më 31.12.2022

Institucioni Nacional Qendra për Konservim – Gostivar, ka nevojë për punësimin e 3 (tre) ushtrues ofrues të shërbimeve për periudhë të caktuar kohore deri më 31.12.2022, për këto vende pune:

1. Për vendin e punës Konservator punonjës i kualifikuar për trashëgimi arkeologjike me shifër KUL 0304 D03 003.

Kushtet e veçanta: Shkalla dhe lloji i arsimimit: I lartë – Arkeologji ose Historia e artit/arkeologji me më së paku 240 kredi të marra sipas SETK ose të përfunduar shkallën VII/1

Përvoja e punës: Me përvojë pune; deri në një (1) vit pune në profesion, (Orari i punës është 8 (tetë) orë në ditë, orari javor i punës është 40 (dyzet) orë në javë) paga bazë neto 34.968 denarë.

2. Për vendin e punës Konservator punonjës i kualifikuar për trashëgimi arkitekturore me shifër KUL 0304 D03 003.

Kushtet e veçanta: Shkalla dhe lloji i arsimimit: I lartë – Arkitekturë, Urbanizëm dhe planifikim me më së paku 240 kredi të marra sipas SETK ose të përfunduar shkallën VII/1

Përvoja e punës: Me përvojë pune; deri në një (1) vit pune në profesion, (Orari i punës është 8 (tetë) orë në ditë, orari javor i punës është 40 (dyzet) orë në javë) paga bazë neto 34.968 denarë.

3. Për vendin e punës Konservator punonjës i kualifikuar për statikë me shifër KUL 0304 D03 003.

Kushtet e veçanta: Shkalla dhe lloji i arsimimit: I lartë – Ndërtimtari dhe menagjim i ujrave me më së paku 240 kredi të marra sipas SETK ose të përfunduar shkallën VII/1

Përvoja e punës: Me përvojë pune; deri në një (1) vit pune në profesion, (Orari i punës është 8 (tetë) orë në ditë, orari javor i punës është 40 (dyzet) orë në javë) paga bazë neto 34.968 denarë.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte të përgjithshme për punësim edhe atë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Të përdor në mënyrë aktive gjuhën maqedonase;
- Të jetë në moshë madhore;
- Të ketë aftësi shëndetësore për vendin e punës; dhe
- Me vendim gjyqsor të formës së prerë nuk është i dënuar me ndalim të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte të veçanta:

- të ketë kualifikimet e duhura profesionale të kërkuara për vendin e punës;
- të ketë përvojë pune të përshtatshme me vendin e punës; dhe
- të posedojë kompetenca të tjera të veçanta të duhura për vendin e punës nëse kërkohet.

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme për plotësimin e kushteve të përgjithshme për vendin e punës, në origjinal ose kopje të noterizuar, edhe atë:

- Certifikatë shtetësie (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- Vërtetim mjekësor për punësim (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- Vërtetim se nuk ka ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- Fletparaqitje të plotësuar për punësim;
- Biografi të shkurtë;
- Letër motivuese të shkurtë.

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme për plotësimin e kushteve të veçanta për vendin e punës, në origjinal ose kopje të noterizuar, edhe atë:

- Diplomë / certifikatë e arsimit të përfunduar;
- Dëshmi e përvojës së punës/profesionit për vendin e punës së përcaktuar.

Shpallja publike për punësim do të publikohet në ueb faqen e IN Qendra për Konservim – Gostivar dhe poashtu do të shpallet në tre gazeta ditore, ku njëra prej të cilave botohet në gjuhën që flasin së paku 20% e qytetarëve që flasin një gjuhë tjetër zyrtare ndryshe nga gjuha maqedonase, me kohëzgjatje prej pesëmbëdhjet (15) ditësh.

Kandidatët, fletparaqitjet e plotësuar, të plota dhe me të dhëna të sakta, me dokumentet e nevojshme duhet ti dorëzojnë në arkivin e IN Qendra për Konservim – Gostivar, çdo ditë pune nga ora 08:30 – 16:30 ose me postë në adresën e mëposhtme IN Qendra për Konservim – Gostivar, rr. Major Çede Filiposki nr.pn P.Fax. 54 – Gostivar, e cila gjendet në ndërtesën e ish-shtëpisë së pionerve, me referencë: Shpallja publike nr.01/2022.

Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike, nga Komisioni për zbatimin e procedurës së punësimit do të njoftohen për vendin dhe kohën e çdo faze vijuese të procedurës së përzgjedhjes, pra për vendet e punës janë këto faza:

Faza 1 - Përzgjedhja administrative – verifikimi i të dhënave në fletparaqitje sipas kushteve të parapara në shpalljen dhe kontrollimi i dokumenteve të bashkangjitur;

Faza 2 – Intervistë

Nëse në shpalljen publike paraqiten deri në 200 kandidatë për një vend pune, përzgjedhja do të bëhet brenda 45 ditëve, nga 201 deri në 500 kandidat për një vend pune përzgjedhja do të bëhet brenda 90 ditëve dhe mbi 500 kandidatë për një vend pune përzgjedhja do të bëhet brenda 120 ditëve, pas përfundimit të afatit për paraqitje.

Fletparaqitjet do të jenë në dispozicion në ueb-faqen e IN Qendra për Konservim – Gostivar www.conservetion.gov.mk, si dhe mund të merren nga arkivi i IN Qendra për Konservim – Gostivar çdo ditë pune nga ora 08:00 der ora 16:00

Me fletparaqitjen kandidatët obligohen ti bashkangjesin dëshmitë e nevojshme për të dhënat e shkruara në të.

Kandidatët detyrohen me përgjegjësi materiale dhe penale të konfirmojnë se të dhënat në fletparaqitje janë të sakta, ndërsa dokumentacionet e paraqitura janë të vërteta dhe origjinale.

Të drejtë për paraqitje kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut të cilët i plotësojnë kushtet për konkurim. Kushtet e parapara në shpallje, kandidatët duhet ti përmbushin në momentin e paraqitjes.

Dokumentacionet jo të plota dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.

Personi për kontakt: Elmedin Kasami, mob.: 078/338-008